

STATUT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ADESTA SH.P.K

Sot më datë, **09.01.2023**, Ortakët e Shoqërisë ADESTA sh.p.k vendosën që në bazë të ligjit të hartojnë dhe miratojnë këtë akt i cili përbën njëkohësisht statutin dhe aktin e themelimit të Shoqërisë me përbajtje si më poshtë vijon:

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES
SË INTERNETIT

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. **ADESTA sh.p.k** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me datë themelimi **09.01.2023**, në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe që funksionon në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
2. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **ADESTA sh.p.k**.
3. Në dokumenta, akte të tjera shkresore, fatura, njoftime dhe akte të tjera të nxjerra ose pranuar prej shoqërisë, emri i saj do të paraprihet ose pasohet nga:
 - a. fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “sh.p.k”,
 - b. numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS),
 - c. vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj, si dhe
 - d. shënimin përkatës nëse kjo shoqëri është në likuidim.
4. Ortakët themelues të Shoqërisë **ADESTA sh.p.k** sh.p.k është:

Taulant Qypi, i datëlindjes 26.04.1977, lindur në Përmet dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti (pasaportë) me nr. BI0693317 dhe nr.personal H70426185P.


Adrian Martini, i datëlindjes 04.02.1977, lindur në Peshkopi, Dibër, dhe banues në Tiranë, identifikuar nga dokumenti (pasportë) me nr. BC9341491 dhe nr.personal H70204062G.

Esi Sulaj, e datëlindjes 05.12.1999, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti (pasaportë) me nr. BE7909406 dhe nr.personal J96205029J.

Neni 2
Objekti

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të ushtrojë kryesisht aktivitetin e mëposhtëm:

Në fushën e ndërtimit :



- Gërmime dhe me punime eventuale murature e beton arme, prishje dhe punime në tokë të gërmuar, prodhim materiale ndertimi, ndërtime civile dhe ekonomike, rrugore;
 - Ndërtimi, riparimi, rikonstruksioni i veprave civile, rezidenicale;
 - Ndërtime vepra infrastrukturore si rrugë, përfshirë edhe veprat e artit, hekurudha, kanale kulluese, ujësjellësa, rrjete elektrike, diga etj;
 - Kryerje punimesh të natyrës elektrike hidraulike, hidroteknike;
 - Ndërtimi, riparimi, rikonstruksioni i strukturave industriale, turistike, bujqësore përfshirë edhe kryerjen e instalimit dhe montimit të impianteve në funksion të tyre;
 - Realizimi i punimeve restauruese;
 - Ndërtime hekurudhore, ura dhe vepra arti, detare, hidraulike dhe hidroteknike;
 - Vepra të veçanta e punime speciale restaurimi, karpentierie, impiante teknologjike e të veçanta;
 - Punime montimi si dhe punime në impiantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë;
 - Punime shërbimi, topogjeodezike, shëmbje, riparimi;
 - Realizimi i studimit dhe projektimit të veprave dhe strukturave të mësipërme;
 - Realizimi i punimeve të posacme të ndërtimit nëpërmjet kontraktimit me subjekte të tjera juridikë dhe/ose fizikë që operojnë në këto fusha;
 - Prodhim i materialeve të ndërtimit, përpunimi dhe tregtimi i tyre;
- Në fushën e tregtisë:**
- Krijimi i shoqërive të tjera ku shoqëria do të jetë ortak dhe/ose aksioner;
 - Tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshëm që lejon legjislacioni në fuqi. Importi dhe eksporti i tyre;
 - Kryerja e shërbimeve të ndërmjetësimit, shërbimeve të konsulencës në fusha të caktuara;
 - Kryerja e çdo veprimtarie në funksion të aktivitetit kryesor që është zbatimi i punimeve të ndërtimit.
 - Shitblerje e pasurive të paluajtshme.
 - Ushtrimi i çdo aktiviteti tregtar që do të ushtrohet sipas legjislacionit shqiptar;

Neni 3 Kohëzgjatja

1. Shoqëria do të kryejë aktivitet tregtar për një afat të pacaktuar.

Neni 4 Selia dhe Adresa Elektronike

1. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Sali Butka, Ndërtesa 13, Hyrja 2, Ap.2, Zona Kadastrale 8250, Nr pasurise 1/59+1-42, volumi 19, faqe 217, Kodi Postar 1023, Tiranë.
2. Shoqëria me vendim të Asamblesë mund të zhvendosë zyrën e saj qendrore ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me miratim paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: adesta@gmail.com





KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në vlerën 100,000 lekë (njëqind mijë lekë), i përbërë nga 3 (tre) kuota me vlerën 100,000 lekë (njëqind mijë lekë) që zotërohet nga ortakët si më poshtë:
 - Ortaku Themelues Z.Taulant Qypi, zotërues i një kuote, me vlerë të përgjithshme 45,000 (dyzet e pesë mijë lekë) që përbën 45% të kapitalit themeltar.
 - Ortaku Themelues, Z.Adrian Martini, zotërues i një kuote, me vlerë të përgjithshme 45,000 (dyzet e pesë mijë lekë) që përbën 45% të kapitalit themeltar.
 - Ortaku Themelues Znj. Esi Sulaj, zotëruese e një kuote, me vlerë të përgjithshme 10,000 (dhjetë mijë lekë) që përbën 10% të kapitalit themeltar.

Neni 6 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) kontratës së shitjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe akti noterial nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga regjistrimi ose publikimi i kontratës apo i kalimit të titullit në regjistrin tregtar.
4. Subjekti që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në regjistrin tregtar.
5. Shoqëria mbart detyrimin që në zbatim të ligjit të regjistrojë kalimin e kuotës në regjistrin tregtar, deklarim ky i cili ka efekt deklarativ.

Neni 7

Shpërndarja e fitimeve dhe kufizimet në lidhje me shpërndarjen e fitimeve

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë dhe fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me pjesën e kapitalit të shoqërisë të zotëruar prej tyre.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b. shoqëria ka aktive likuiditete të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
3. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 2 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
4. Kërkesat e mësipërme të pikave 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare në lidhje me ndalimin, konfliktin e interesit dhe personat e lidhur, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.
5. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.

KREU III ORGANET E SHOQËRISË

Neni 8 Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Administratori

Neni 9 Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare;



- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” e “d” të këtij neni;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- n) shitja, barrësimi, vendosja peng apo hipotekimi i çdo titulli, të drejte ose interesi mbi aktivet ose pronat e shoqërisë;
- o) miratimin e huave ose garancive nga shoqëria për detyrimet e palëve të treta;
- p) zmadhimi dhe/ose marrja e kredive dhe/ose overdraft-ve nga bankat ose nga institucione të tjera financiare;
- q) transferimi i markave dhe çdo pronësie intelektuale të shoqërisë ose të zotëruara nga shoqëria në bazë të licencave përkatëse;
- r) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 10 **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji ose nga dispozitat e statutit dhe gjithashtu mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e pakicës që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen për atë kohë sa shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

Neni 11 **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, Përfaqësimi në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, Kuorumi, Marrja e Vendimeve, E drejta e votës**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 më lart.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij neni.



4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi sipas pikës 4 të këtij neni jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
7. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kapitalit të shoqërisë. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, dhe konkretisht për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.
8. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 7 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
9. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 9 të këtij Statuti, përveç atyre që janë përmendur në pikën 7 të këtij neni dhe për të cilat asambleja e përgjithshme merr vendim me shumicë të cilësuar, për çështjet e tjera asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
10. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
11. Në përputhje me këtë statut, çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.
12. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
13. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



15. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 12 **Hetimet e Posaçme**

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.
5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Neni 13 **Administrimi i Shoqërisë**

1. Emërohet si administrator:



Z. Adrian Martini, i biri i Xhafer dhe i Humie, me datëlindje 04.02.1977, lindur në Peshkopi, Dibër dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga Andon Zako Çajupi, Nd. 1835, H.0; Ap.030, Tiranë, Cel: 0692199621, mbajtës i pasaportës me Nr. BC9341491 dhe nr personal H70204062G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

2. Afati i emërimit të administratorit është 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundërdrejtohet palëve të treta kur bëhet publik në mënyrën e përcaktuar nga Ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
 - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - a) përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese, pasi në të kundërt përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë;
 - b) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - c) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - d) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - e) të kryejë detyrat e përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - f) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - g) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - h) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

- i) të ushtrojë detyrat me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm;
 - j) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
5. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 4 të nenit 10 të këtij Statuti, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.
6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 14

Detyrimi i Besnikërisë, Informimit dhe Përgjegjësia e Administratorit

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, Administratori i shoqërisë vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë në radhë të parë dhe të gjithë ortakëve të saj në mënyrë të barabartë. I njëjti detyrim vlen dhe për ortakët e shoqërisë.
2. Administratori i shoqërisë ka detyrimin të informojë rregullisht çdo 3 (tre) mujor të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë sipas mënyrës së kërkuar nga secili ortak dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vendosë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në shpenzimet e shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, deklarata për të ardhurat, deklarata të tjera financiare, dokumentacionin fiskal të shoqërisë, por pa u kufizuar në sa më lart.
3. Informacioni i kërkuar sipas pikës 2 të këtij neni duhet të vihet në dispozicion për shqyrtim nga ortaku i interesuar pranë selisë së Shoqërisë. Nëse administratori nuk jep informacionin e kërkuar sipas këtij paragrafi brenda 7 ditëve nga marrja dijani e kërkesës për informacion, ortaku i interesuar brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë përmbaruesin gjyqësor të ekzekutojë kërkesën e ortakut duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që Administratori nuk ka dhënë.

Neni 15 Viti Fiskal

1. Viti fiskal i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

KREU IV DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 16 Dividendët



1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me pjesën e kapitalit të zotëruar prej tyre në Shoqëri.
3. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
4. Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.
5. Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar votash, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë.

KREU V PRISHJA e SHOQËRISË DHE NJOFTIMET

Neni 17 Prishja e Shoqërisë

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
 - a) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - b) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - c) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga ligji;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, vendoset nga asambleja e përgjithshme me shumicë të cilësuar.

Neni 18 Likuidimi i Shoqërisë



1. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
2. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme.
3. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi "në likuidim".
4. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
5. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
6. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga asambleja e përgjithshme.
7. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve.

Neni 19 Dispozita të ndryshme

1. Ky akt që përbën statut dhe akt themelimi të shoqërisë mund të shtohet, ndryshohet ose të zëvendësohet me një Statut të ri me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të cilësuar.
2. Riorganizimi apo prishja e Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
3. Ortakët dhe administratorët do të ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me parimet e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe në veçanti duke respektuar detyrimin për besnikëri të parashikuar në këtë ligj.
4. Në emërimin e administratorëve, përfaqësuesve të ortakëve, apo përfaqësueve të tjerë ligjorë të shoqërisë, duhet të mbahet parasysh që këto persona të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në kreun III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 (pesë) vjet nga data e këtij dënimi.

5. Të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë Statut, i nënshtrohen rregullimit nga dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dispozitat e Kodit Civil dhe çdo lloj ligji të aplikueshëm të Republikës së Shqipërisë.

Neni 20
Mosmarrëveshjet

1. Çdo mosmarrëveshje e mundshme ndërmjet palëve do të zgjidhet me mirëkuptim.
2. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 21
Statuti dhe Akti i themelimit

Ky akt me përmbajtjen e mësipërme përbën njëkohësisht statutin dhe aktin e themelimit të Shoqërisë.


Ky statut dhe akt themelimi u miratua nga Ortakët më datë **09.01.2023**

ORTAKËT THEMELUES

1.Taulant Qypi



2.Adrian Martini



3.Esi Sulaj

